



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 60/01-20332/21
Kaçanik, 30.07.2021

Në bazë të nenit 12.1 dhe nenit 82.3 të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisje Lokale(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008), nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L- 031-për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/16 Qershor 2016) si dhe në bazë të nenit 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, duke vepruar sipas Kërkesës së MAPL 020-144/15 të datës 13.07.2021, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 Korrik 2021, mori këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT 01NR.60/01-18413/21 TË DATËS 30.06.2021, ME TË CILIN ËSHTË NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR VENDIMI PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

1. Me këtë Vendim, ANULOHEM Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr.60/01-18413/21 i datës 30.06.2021 me të cilin është ndryshuar dhe plotësuar Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 01Nr. 60/01-1785/2018 i datës 24.01.2018, Vendimi 01Nr. 60/01-5524/2018 i datës 28.02.2018 dhe Vendimi 01Nr. 060/01-27538/20 i datës 23.11.2020.
2. Anulimi i Vendimit i përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet sipas Kërkesë të MAPL 020-144/15 të datës 19.07.2021, për shkak së i njëjti është në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 7 dhe 8 të Ligjit Nr.05/L-020 –Për Barazi Gjinore.
3. Me marrjen e këtij Vendimi, mbetën në fuqi Vendimi 01Nr. 60/01-1785/2018 i datës 24.01.2018 si dhe vendimet për ndryshim plotësimin e vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 01nr. 60/01-5524/2018 i datës 28.02.2018 dhe 01Nr. 060/01-27538/20 i datës 23.11.2020.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe mekanizmat tjerë relevantë.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Hafize Sallahi, Bekim Koxha, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komune e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01 Nr. 60/01-1785/21
Kaçanik, 30.06.2021

Në bazë të nenit 51 dhe 52 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen e Lokale, të nenit 39.1 të Statutit të Komunës, të nenit 13 pika 3.5 e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2014- Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme në Komunë, të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2018 - Për Ndryshim Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2014 -Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme në Komunë, të deklarimit të Hafize Sallahi në mbledhjen e KK të datës 15.06.2021, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vetë mbajtur me 30 Qershor 2021, mori këtë:

V E N D I M

PËR NDYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01NR. 60/01-1785/2018 I DATËS 24.01.2018 SI DHE VENDIMET PËR NDYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA 01NR. 60/01-5524/2018 I DATËS 28.02.2018 DHE 01NR. 060/01-27538/20 I DATËS 23.11.2020.

1. Me këtë Vendim, Ndryshohet dhe Plotësohet, Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-1785/2018 i datës 24.01.2018, si dhe Vendimet për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 01Nr. 60/01-5524/2018 i datës 28.02.2018 dhe 01Nr.060/01-27538/20 i datës 23.11.2020.

2. Ndryshim Plotësimi i Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të përcaktuara si në pikën 1. të këtij Vendimi, bëhet në çdo në paragrafë dhe pikë të Vendimit ku është shënuar emri i anëtares nga NISMA, Hafize Sallahi, ashtu që nga Komiteti për Politikë dhe Financa hiqet Hafize Sallahi, për shkak të kalimit të saj në subjekt tjetër politik- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

2.1 Për anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa emërohet Bekim Koxha, nga subjekti politik, NISMA Socialdemokrate.

3. Me Ndryshim plotësimet që kanë pësuar Komiteti për Politikë dhe Financa, tani me këtë Vendim ka këtë përbërje:


2.1. Kemal Mërseli	PDK	Kryesues sipas funksionit
2.2. Nexhat Loku	PDK	anëtar,
2.3. Pranverë Loku-Zharku	PDK	anëtare,
2.4. Ekrem Kyçyku	LVV	anëtar,
2.5. Selim Reka	LDK	anëtar,
2.6. Rabije Sallahi	AAK	anëtare, dhe
2.7. Bekim Koxha	NISMA	anëtar.

4. Pikët tjera të Vendimit mbesin të pandryshuara.

5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Hafize Sallahi, Bekim Koxha, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, Drejtorja për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK

Data	16.07.2021	Vendi	KAC
Nj. org.		Numri	60/01-20332
	01	Shtoj	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemajl Mërseli, Kryesues i kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Date: 07.07.2021 Nr-020-144/14
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e aktit të Komunës së Kaçanikut	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuara Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01.Nr.60/01.18413/21 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01Nr.60/01-1785/2018 i datës 24.01.2018 si dhe vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për formimin e komitetit për politikë dhe financa 01Nr.60/01-5524/2018, i datës 28.02.2018 dhe 01Nr.060/01-27538/20 i datës 23.11.2020

I miratuar më datë: 30.06.2021

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.07.2021

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim
1.	Vendimi 01.Nr.60/01.18413/21 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01Nr.60/01-1785/2018 i datës 24.01.2018 si dhe vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për formimin e komitetit për politikë dhe financa 01Nr.60/01-5524/2018, i datës 28.02.2018 dhe 01Nr.060/01-27538/20 i datës 23.11.2020	Ky vendim nuk është në përputhje me Ligjin Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore, nenin 6, paragrafin 7 dhe 8, ku parashihet se: "Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse". Gjithashtu, Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal dhe Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, më datë: 18.12.2017, ka dërguar një shkresë shpjeguese në komuna lidhur me respektimin e Ligjit Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Kaçanikut, që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komune e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik
01 Nr.060/01-27538/20
Kaçanik, 23.11.2020

Në bazë të nenit 51 dhe 52 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen e Lokale, të nenit 39.1 të Statutit të Komunës, të nenit 13 pika 3.5 e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2014- Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme në Komunë, të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2018 - Për Ndryshim Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2014 -Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme në Komunë, të Kërkesës së Rabije Sallahi 01Nr. 060/01-27538/20 të datës 30.10.2020, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 23 Nëntor 2020, mori këtë:

V E N D I M

PËR NDYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01NR. 60/01-1785/2018 –PËRKATËSISHT VENDIMIT PËR NDYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01Nr. 60/01-5524/2018- PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

1. Me këtë Vendim, Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-1785/2018 i datës 24.01.2018- përkatësisht Vendimit për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-5524/2018- për Ndryshim Plotësimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa i datës 28.02.2018.

2. Ndryshim Plotësimi i Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të përcaktuara si në pikën 1. të këtij Vendimi, bëhet në çdo në paragrafë dhe pikë të Vendimit ku është shënuar emri i anëtares, Albana Troni, ashtu që nga Komiteti për Politikë dhe Financa hiqet Albana Troni për shkak të kalimit të saj në subjekt tjetër politik- Lëvizjen Vetëvendosje(LVV).

2.1 Për anëtare të Komitetit për Politikë dhe Financa emërohet **Rabije Sallahi** nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

3. Me Ndryshim plotësimet që kanë pësuar Komiteti për Politikë dhe Financa, tani me këtë Vendim ka këtë përbërje:

2.1. Kemal Mërseli	PDK	Kryesues sipas funksionit
2.2. Nexhat Loku	PDK	anëtar,
2.3. Pranverë Loku-Zharku	PDK	anëtare,
2.4. Ekrem Kyçyku	LVV	anëtar,
2.5. Selim Reka	LDK	anëtar,
2.6. Rabije Sallahi	AAK	anëtare, dhe
2.7. Hafize Sallahi	NISMA	anëtare.

4. Pikët tjera të Vendimit mbesin të pandryshuara.

5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Rabije Sallahi, Albana Troni, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komune e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kaçanik

01 Nr. 60/01-5524/2018
Kaçanik, 28. 02. 2018

Në bazë të nenit 51 dhe 52 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen e Lokale, të nenit 39.1 të Statutit Komunës, në zbatim të pikës 3 të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01 Nr. 60/01-1785/2018 i datës 24 Janar 2018, Kuvendi i Komunës Kaçanik, me datë 28 Shkurt 2018, mori këtë :

V E N D I M
PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR
POLITIKË DHE FINANCA

1. Me këtë Vendim plotësohet Vendimi i Kuvendit të Komunës, për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) 01 Nr. 60/01-1785/2018 i datës 24.01.2018 me dy anëtarë në rubrikat e zbrazura të pikës 2 paragrafët, 2.4 dhe 2.5 nga dy subjektet politike të përcaktuara në Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me një (1) anëtar dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me një (1) anëtar, si vijon;
 - 1.1. Nga Subjekti Politik i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) anëtar i KPF emërohet,
Ekrem Kyçyku,
 - 1.2. Nga Subjekti politik i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) anëtar i KPF emërohet
Selim Reka.
 - 1.3. Pika 2.6 e Vendimit 01 Nr. 60/01-1785/2018 të Kuvendit të Komunës i datës 24 Janar 2018, ndryshohet dhe plotësohet si vijon; nga Komiteti për Politikë dhe Financa hiqet, **Hajredin Luta**, ndërsa në vend të tij emërohet, **Albana Troni**, nga subjekti politik i AAK, për shkak të balancimit gjinor.
2. Me ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit për Formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa, është si vijon:

1. Kemal Mërseli,	nga PDK	Kryesues sipas funksionit,
2. Nexhat Loku	nga PDK	anëtar,
3. Pranverë Loku-Zharku,	nga PDK	anëtar,
4. Ekrem Kyçyku	nga LVV	anëtar,
5. Selim Reka	nga LDK	anëtar,
6. Albana Troni	nga AAK,	anëtar, dhe
7. Hafize Sallahi	nga NISMA	anëtar.
3. Pikët të tjera të Vendimit mbesin të pandryshuara.
4. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit 01 Nr. 60/01-1785/2018 i datës 24.01.2018 për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Kuvendit Kryetari i Komunës, Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkivi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komune e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01 Nr. 60/01-1785/2018
Kaçanik, 24.01.2018

Në bazë të nenit 51 dhe 52 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen e Lokale, të nenit 39.1 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 24 Janar 2018, mori këtë :



V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA


- Me këtë Vendim formohet Komiteti për Politikë dhe Financa, i Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në përbërje 7 anëtarëve.
- Komiteti për Politikë dhe Financa, ka këtë përbërje:

2.1. Kemal Mërseli	PDK	Kryesues sipas funksionit
2.2. Nexhat Loku	PDK	anëtar,
2.3. Pranverë Loku-Zharku	PDK	anëtar,
2.4. ...	L.VV	anëtar,
2.5. ...	LDK	anëtar,
2.6. Hajredin Luta	AAK	anëtar, dhe
2.7. Hafize Sallahi	NISMA	anëtar.
- Komiteti për Politikë dhe Financa do të plotësohet me dy anëtarë në rubrikat e zbrazura të pikës 2 paragrafët. 2.4 dhe 2.5 nga dy subjektet politike të përcaktuara: L.VV me një (1) anëtar dhe LDK me një (1) anëtar, pasi t'i japin propozimet këto dy subjekte politike.
- Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa reflekton përfaqësimin e etnitetëve politike në Kuvendin e Komunës, dhe barazinë gjinore.
- Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, sipas funksionit që e ka.
- Detyrat e Komitetit për Politikë dhe Financa janë të përcaktuara në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit.
- Kompensimi për punën e Komitetit për Politikë dhe Financa rregullohet me Vendim, të veçantë sipas Udhëzimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njostohen: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Arkivi

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi , Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi , Ministër i MAPL-së Trim Berisha , Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani , Z.v. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 10.08.2021 Nr.020-144/16
Zyrtaret përgjegjës:	Gëzim Sahiti , Z.v. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj , Zyrtar e lartë për monitorim të komunave	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut	
Lloji i aktit:	☐ Rregullore e Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01Nr.60/01-20332/21 për anulimin e vendimit 01.Nr.60/01.18413/21 me të cilin është ndryshuar dhe plotësuar vendimi për formimin e komitetit për politikë dhe financa
I miratuar më datë: 30.07.2021
I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 05.08.2021

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**. Ndërsa sa i përket përmbajtjes është në kompetencë të komunës të zbatoj në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.